



Të dashura familje

Ne në Bordin Shkollor të Qarkut Hamilton-Wentworth (HWDSB) jemi të angazhuar për identifikimin dhe heqjen e pengesave, që t'u ofrojmë të gjithë nxënësve ambiente mbështetëse, përfshirëse dhe të respektueshme.

Për të mësuar më shumë për studentët tanë, ne do të realizojmë një regjistrim vullnetar dhe me karakter konfidencial. Në prill 2021, *Ne të gjithë Vlejmë: Censusi Studentor 2021 i HWDSB* u hap dhe u bënë pyetje rreth identitetit të studentëve (racës, gjinisë, etj.) për të identifikuar dhe adresuar barrierat sistemike. Për shkak të shkallës së ulët të përgjigjeve të shkaktuara nga situata pandemike, po e hapim Censusin Studentor përsëri për t'u ofruar të gjithë studentëve mundësinë për përfundimin e censurit. Kjo do të ndodhë nga data 29 nëntor 2021 deri më 16 dhjetor 2021.

Shumë borde shkollash kanë zhvilluar një census të studentëve. Në fakt, Ligji mbi Anti-Racizmin 2017 dhe Planveprimi i Barazisë Arsimore në Ontario kërkojnë nga bordet e shkollave mbledhjen dhe raportimin e këtyre të dhënave. Ky është gjithashtu edhe një projekt prioritar në Planveprimin e Barazisë në HWDSB.

Ne jemi të vetëdijshëm se pyetjet në lidhje me identitetin e një personi mund të jenë të pakëndshme, dhe do të veprojmë me ndjeshmëri në këtë aspekt. Ne u këshilluam me studentët, familjet, personelin dhe anëtarët e komunitetit në mënyrë që ky census të ndihmojë HWDSB në marrjen e vendimeve të bazuara në prova për mbështetjen e barazisë, arritjeve të studentëve dhe mirëqenien e tyre.

[Si do të realizohet kjo?](#)

Nga mosha e kopshtit deri tek studentët e klasës së 4-t: Në Portalin Prindëror do të shtohet një formular. Prindërit dhe kujdestarët mund të hyjnë në Portal, të hapin formularin, dhe të plotësojnë Censusin Studentor në këtë vendndodhje. Kopjet e shtypura disponohen sipas kërkesës për mësuesin e fëmijës suaj. Ju lutem plotësoni vetëm një formular censusi për student (përmes internetit ose në formatin e printuar).

Klasat e 5-të deri në të 12-të - studentët që paraqiten personalisht dhe ata që mësojnë në distancë: Edhe një herë do të dërgojmë me postë elektronike një link të sigurt për studentët e klasave të 5-ta deri në të 12-ta, në mënyrë që ata të mund të plotësojnë formularin e censurit në internet gjatë orarit të mësimin në klasë, me mbështetjen e mësuesit. Studentët për të cilët prindërit/kujdestarët kanë kërkuar paraprakisht të MOS marrin pjesë në census nuk do të marrin email.



Çfarë do të kërkohet?

Në varësi të moshës së studentit, pyetjet në census mund të bëhen në lidhje me gjuhët e folura nga ana e studentit, identitetin indigjen, përkatësinë etnike, racën, fenë, identitetin gjinor, orientimin seksual, aftësitë (e kufizuara), vendin e lindjes dhe nënshtetësinë / statusin e imigracionit.

Si do ta mbrojë HWDSB informacionin personal të studentëve?

HWDSB angazhohet në nivelet më të larta të privatësisë dhe konfidencialitetit gjatë procesit të mbledhjes së informacionit për studentët dhe familjet. Të dhënat e censusit të studentëve janë mbledhur nën autoritetin e Ligjit mbi Anti-racizmin, 2017, S.O. 2017 p. 15, Ligji mbi Arsimin, R.S.O. 1990 p. E.2, dhe përputhet me Ligjin mbi Lirinë Komunale të Informimit dhe Mbrojtjen e Privatësisë, R.S.O. 1990 p. M.56.

Censusi studentor është konfidencial, por nuk është anonim. Përgjigjet individuale të studentëve do të grupohen së bashku për analizë në mënyrë që asnjë informacion individual i studentëve të mos jetë i identifikueshëm. Përgjigjet e mbledhura do të ruhen në një bazë të dhënash të sigurt, konfidenciale dhe qasje do të ketë vetëm personeli i HWDSB autorizuar për kërkime dhe analizim për të identifikuar dhe për të përmbledhur tendencat e studentëve HWDSB.

A është e detyrueshme?

Plotësimi i censusit është vullnetar. Sidoqoftë, u kërkohet nxënësve të marrin pjesë në mënyrë që të merret një informacion i saktë i popullsisë sonë studentore. Një shkallë e lartë përgjigjesh do të na ndihmojë të identifikojmë pengesat, të krijojmë strategji, dhe adresojmë barrierat për arritjet e studentëve dhe mirëqenien e tyre përmes programeve dhe burimeve tona. Studentët të cilët kanë zgjedhur tashmë të mos marrin pjesë nuk do të marrin një link sondazhi kur të ri-hapet. Familjet që nuk duan që fëmijët e tyre të marrin pjesë dhe nuk kanë bërë më parë këtë zgjedhje mund të dërgojnë email në research@HWDSB.on.ca.

Pyetjet?

Ne ftojmë për pyetje dhe u përgjigjemi atyre ndërsa përgatitemi për censusin. Ju lutem mësoni më shumë në faqen e internetit www.hwdsb.on.ca/weallcount, ku ju do të gjeni Pyetje të Bëra më Shpesh (FAQs) në lidhje me censusin. Ju gjithashtu mund të kontaktoni ekipin tonë të regjistrimit të studentëve në census@HWDSB.on.ca.

Ju faleminderit që ndihmuat HWDSB-së të mbledhë të dhëna në mënyrë të përgjegjshme, në mënyrë që të na jepet mundësia të krijojmë rezultate më të barabarta në sistemin arsimor.

HWDSB



Me respekt

A handwritten signature in black ink that reads "Manny Figueiredo".

Manny Figueiredo
Drejtori i Arsimit

A handwritten signature in black ink that reads "Paul Denomme".

Paul Denomme
Mbikëqyrës për arritjet e studentëve,
barazinë dhe angazhimin studentor